Nevoja e shprehjes” të drejtat e njeriut” filloi në fund të shekullit 18-të ( në deklaratën e të drejtave të njeriut dhe qytetarëve ne Francë të vitit 1789-“*les droits de l’homme*”, por nevojën më te gjerë e arriti vetëm në gjysmën e shekullit të 20-të. Gjithçka deri në përfundim të shekullit të tetëmbëdhjetë, kanë përdorur më shumë termin “ e drejta e natyrshme”. Në përgjithësi në thelb, të dyja termat vijnë nga e njejtja rrjedhshmëri dhe filozofi tradicionale që i kanë konsideruar se” të drejtat e natyrshme” buron nga “zakonet natyrore.”

Edhe pse doktrina e së drejtës natyrore i ka rrënjët thellë në Greqinë e lashtë dhe Romë, zhvillimi i mëtejshëm i konceptit të të drejtave të njeriut përmes kartave mesjetare, mësimëve të edukatorëve dhe filozofëve të epokës së re, të gjitha këto deri në dokumentet kryesore rreth të drejtave të njeriut sot, shkaktoi zgjerimin e tij përmes vlerave universale të mbajtura në burime të ndryshme ligjore.

Të drejtat e njeriut, zakonisht përcaktohen në literaturën juridike si një tërësi e të drejtave dhe lirive që u përkasin të gjithë njerëzve. Bashkangjitur me këtë përkufizim shpesh shtohen fjalë që i referohen patjetërsueshmërisë së të drejtave të njeriut dhe origjinës së tyre natyrore.<sup>6</sup>

Ideja e të drejtave të njeriut lidhet me vetë natyrën e njeriut si qenie njerëzore që lind i lirë dhe të cilit të drejtat e njeriut me vet faktin i përkasin si të patjetërsueshmes. Kjo vërtetohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut duke kujtuar se të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë, me dinjitet dhe të drejta të barabarta. Ata e janë të lindur me arsyen dhe vetëdijen, prandaj duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymën e vëllazërisë.

Të drejtat e njeriut janë të drejta subjektive dhe në të njëjtën kohë një grup vlerash universale pa të cilat një qenie njerëzore nuk mund të zhvillohet në tërësinë e saj, në të gjitha nivelet e tij të zhvillimit. Në plan të parë, ajo sjell vlerat e vërteta të jetës njerëzore dhe komunitetit njerëzor, duke ju përkushtuar me përgjegjësi të plotë individualisht dhe grupeve ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve, ndaj botës, natyrës dhe jetës.

---

6 S. Gajin, *Të drejtat e Njeriut, E drejta- forma e sistemit*,”Studio Dostije”, Beograd, viti 2012, faqja nr.15

Nga ana tjetër, kërkesa për realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut gjithmonë orientohen drejt shtetit brenda të cilit lind një rend objektiv juridik pra një tërësi rregullash sipas të cilave sillen njerëzit në një shoqëri. Rishkrimi i të drejtave të njeriut në kushtetutë ose ligj nuk ka ndonjë rol zyrtar, por rol deklarativ, sepse me atë verteton atë që tashmë ekziston, të gjitha këto pa njohje zyrtare.

Midis burimeve materiale dhe ligjore të të drejtave të njeriut përfshijnë vlera të ndryshme shoqërore që përmbahen në veprat filozofike dhe teorike si dhe në dokumentat politike, ndërkoh që burimet zyrtare ligjore të të drejtave të njeriut nënkuptojnë akte juridike të miratuara nga e drejta ndërkombëtare dhe asaj e brëndshme.<sup>7</sup>

Matrica e impletimit të brëndshëm nuk është e dhënë paraprakisht dhe bazohet në traditën e duhur ligjore dhe modelit organizativ të qeverisë. Sidoqoftë ,pavarësisht kësaj, përpara qeverisë vendoset qëllimi themelor i cila ndjek parimin e lidhjes së kontratave me mirëbesim dhe do të thotë përfshirje e plotë e standardeve kontraktuale në rendin juridik kombëtar. Ky është i vetmi qëllim themelor e thenë ndryshe i përgjithshmi i zbatimit të çdo marrëveshje ndërkombëtare.

---

<sup>7</sup> N.Vuçiniq, *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*, Podgoricë, viti 2001, faqja nr 12



HISTORIA E  
MBROJTJES  
TË PAKICAVE  
NDËRKOMBËTARE



Zhvillimi historik i mbrojtjes së pakicave daton që nga Paqja e Vestfalisë 1648 që i dha fund luftës tridhjetëvjeçare dhe vendosi një sistem marrëdhëniesh midis fuqive të atëhershme evropiane - shteteve kombe mbi parimin e ekuilibrit të fuqive. Sipas disa dispozitave të traktateve të paqes, fuqitë evropiane pranuan detyrimet e ndërsjellta në lidhje me mbrojtjen e të drejtave fetare të grupeve të ndryshme të pakicave, përkatësisht feve të pakicave. Në këtë mënyrë, janë të garantuara të drejtat e protestantëve në qytetetet e Gjermanisë, të drejtat e katolikëve në zonat Baltike të miratuara nga Suedia protestante dhe në zonat që Franca i dha Hollandës. Më vonë, me Aktin e Kongresit të Vjenës në 1815, Rusia, Austria dhe Prusia u shfaqën si garantues fetarë por edhe sigurues të së drejtave politike të polakëve, të cilët u bënë pakicë në këto shtete për shkak të ndarjes së shtetit të tyre. Kështu, Institucioni i Mbrojtjes së Pakicave po zhvillohet gradualisht, sepse përveç mbrojtjes fetare, ai gjithashtu përfshin mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Në Kongresin e Berlinit në 1878, Mali i Zi u njoh me kusht që të respektoheshin të drejtat fetare të pakicës, popullsisë jo-ortodokse, e cila pas njohjes mbeti duke jetuar brenda kufijve.

Pakicat brënda Lidhjes së Kombeve në kontekstin e sistemit të Versajës për mbrojtjen e pakicave të konstituara në fund të Luftës së Parë Botërore dhe Traktatit të Paqes në Versajë, shënojnë fillimin e një faze të re, shumë domethënëse në zhvillimin e mbrojtjes së pakicave. Ky sistem shfaqet si një formë specifike e pohimit të së drejtës së njerëzve për vetëvendosje, dmth si një formë e kompensimit për këtë të drejtë, në rastet kur nuk ishte e mundur të ushtrohej e drejta e vetëvendosjes përmes krijimit të një shteti të veçantë.<sup>8</sup>

Me këtë sistem, mbrohen pakicat si grupe kolektive ndërsa përfaqësuesit e tyre për të kontrolluar zbatimin e regjimit të parashikuar, kishin të drejtë të paraqiteshin para organeve të Lidhjes së Kombeve. Kështu që për herë të parë në të drejtën ndërkombëtare, pakicat kanë fituar disa elemente të subjektivitetit juridik ndërkombëtar. Detyrimet për të mbrojtur pakicat kishin fuqi ligjore më të lartë se rregulloret kushtetuese të shteteve të cilave u imponoheshin. Zbatimi i tyre

8 N. Vuçiniq, S. Bjeković, B.Bozhović, Aspekti ligjor i të drejtave të pakicave në Mal të Zi/ N. Vuçiniq, B. Bozhović, *Standartet e brojtjes të së drejtave ndërkombëtare të pakicave në Mal të Zi*, Podgoricë, CEZAM, viti 2008, faqja nr 5

u garantua përfundimisht nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, të cilit anëtarët e pakicave ose shoqatat e tyre mund t'i drejtoheshin, duke paraqitur peticione dhe ankesa.

Në sistemin e pakicave të Versajës mbrohen pakicat racore (etnike), fetare dhe gjuhësore, përmes:

- çështjeve të veçanta të pakicave në traktatet e paqes pas Luftës së Parë Botërore - me Austrinë, Bullgarinë, Hungarinë, Turqinë);
- marrëveshjeve të posaçme për mbrojtjen e pakicave (me Poloninë, Republikën Çeke, Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, Greqisë, Rumanisë;
- deklaratave speciale të dhëna para Këshillit të Lidhjes së Kombeve (Shqipëri, Shtetet Balltike, Irak)
- vendosjes së sistemeve të veçanta të pakicave në rajone të caktuara (Ishujt Aland në Finlandë, Silesia e E sipërme në Gjermani).

Kështu, u krijua një sistem kompleks që shtrihej nga Balltiku deri në Gjirin Persik, dhe që u siguronte pakicave mbrojtjen e jetës, lirinë personale dhe lirinë fetare. Gjithashtu, garantohen barazia e të gjithëve para ligjit, të drejtat e barabarta politike dhe civile, e drejta për të përdorur gjuhën amtare para gjykatave dhe autoriteteve të tjera, e drejta për të krijuar institucione kulturore dhe shkolla, si dhe garanci të veçanta të shtetësisë së dyfishtë. Disa të drejta janë të garantuara për individët, të tjerat për grupet e pakicave dhe qarqet.<sup>9</sup>

Edhe pse gjithëpërfshirës dhe kompleks, sistemi nuk ishte universal, gjë që ishte një nga mangësitë themelore. Përkatësisht, ju imponua shteteve të mundura, të sapokrijuara dhe më të vogla jo fuqive të mëdha, të cilat e konceptuan atë dhe garantuan zbatimin e saj përmes Lidhjes së Kombeve. Për më tepër, sistemi nuk ishte i ekuilibruar si duhet, pasi theksonte të drejtat duke neglizhuar plotësisht detyrimet e pakicave, veçanërisht në kontekstin e respektimit të integritetit territorial dhe sovranitetit të shteteve në fjalë. Përveç mangësive të lartpërmendura, sistemi i Versajës u abuzua në mënyrë drastike nga Gjermania naziste dhe Italia fashiste për shpërbërjen e brendshme të

<sup>9</sup> N.Vuçiniq, ibid, faqja nr. 142

shteteve të caktuara (Çekosllovakia, Jugosllavia, Polonia) përmes të ashtuquajturve kolona e pestë e cila përbëhej nga anëtarë të pakicave ose si pretekst për agresion të drejtpërdrejtë kundër këtyre shteteve, me pretekstin e mbrojtjes së bashkatdhetarëve të tyre nga persekutimi. Që nga ajo kohë, ndërgjegjësimi është konsoliduar në bashkësinë ndërkombëtare se si pakica, në rastin kur pozicioni i tyre abuzohet, veçanërisht nga vendi mëmë, mund të bëhet një faktor destabilizues. Kjo njohuri përcaktoi në thelb cilësinë dhe metodat e mbrojtjes së pakicave pas Luftës së Dytë Botërore.

Pas këtij konflikti, veçanërisht në vitet e para të punës së Kombeve të Bashkuara, dominoi mendimi se pakicat nuk duhet të gëzonin ndonjë të drejtë të veçantë, kolektive dhe se mbrojtja e të drejtave të tyre individuale brenda sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut ishte mëse e mjaftueshme. Karta e Kombeve të Bashkuara, si dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, përveç standardeve të përgjithshme ligjore mbi ndalimin e diskriminimit.

Sidoqoftë, shpejt u bë menjeherë e qartë se kjo çështje ishte shumë më komplekse dhe nuk mund të konsiderohej vetëm brenda sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Krijimi i këtij qëndrimi u kontribua veçanërisht nga ankesat e shumta drejtuar organeve të Kombeve të Bashkuara, të cilat filluan të mbërrinin në një numër të madh nga komunitete të ndryshme të pakicave në të gjithë botën. Kështu që, në vitin 1957, u krijua një nën-komision për minoritetet brenda Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Do të ketë kthim në drejtim të miratimit të standardeve nga Pakti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike (DCP), i cili përmban dispozitën më të rëndësishme të ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar të përshkruar nga Neni 27, i cili thotë:

Në shtetet ku janë të pranishme pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore, personat të cilat i përkasin kësaj pakice, nuk mund ti hiqet e drejta në bashkëjetesë me pjesarë të tjere të grupeve të tyre, të kenë jetën e tyre kulturore, të deklarojnë dhe shprehin besimin e tyre dhe përdorin gjuhën e tyre”.

Kjo është dispozita e parë për të drejtat e pakicave që ka pasur një karakter ligjërisht të detyrueshëm në nivelin universal. Përmendim këtu nenin 27-të që solli shumë dyshime si dhe formulime të ndryshme. Kishte një dilemë në lidhje me termat “pakicë” dhe “pakicë etnike” dhe nëse pakicat gëzonin të drejta si individë apo kolektivë. Problemi lindi si pasojë e interpretimit të pjesës së dispozitës i cili thotë “persona që u përkasin këtyre pakicave” si dhe ata që i ushtrojnë ato “në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre”. Përgjigja e pyetjes nëse Pakti mbron të drejtat kolektive apo individuale u dha nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut në Komentin e Përgjithshëm nr. 23 (50) të miratuar në vitin 1994, në lidhje me Nenin 27, paragrafi nr.1, si më poshtë:

“Komiteti konsideron se ky nen përcakton dhe njeh të drejtën e individëve të cilët i përkasin grupeve të pakicave, i cili është specifik dhe i shtohet të gjitha të drejtave të tjera që individët, në bashkëpunim me të tjerët, tashmë gëzojnë sipas dispozitave të Paktit.”

Duke shpjeguar pse të drejtat e Nenit 27 transferohen tek individët dhe jo tek grupet, zyrtarët e KB përmendin, përveç disa arsyeve historike dhe formale, edhe arsyet politike për parandalimin e tensioneve midis pakicave dhe shteteve mbi autoritetin dhe përfaqësimin e grupeve të pakicave dhe të gjithë popullsinë e shtetit.<sup>10</sup>

Nga ana politike dhe ligjore, një dilemë të veçantë la kjo dispozitë edhe për nga mënyra sesi është formuluar ekzistenca apo mosekzistenca e pakicave të një shteti, që do të thotë a ka një shtet të drejtë që vet të vendosi nëse ka në të grupe pakicash. Për shembull, Franca dëshiroi të mbyllte në vetvete zbatimin e Nenit 27 duke patur parasysh që neni i përmendur i kushtetutës së tij nuk njeh dallime etnike dhe kulturore midis shtetaseve dhe për këtë arsye as shumicën dhe as popullatën pakicë. Për këtë arsye, në komentin e përgjithshëm të Komitetit të Parë të Njeriut nr. 23 (50), paragrafi 5.2 thotë:

“Ekzistenca e një pakice etnike, fetare dhe gjuhësore në një shtet anëtar të caktuar nuk varet nga vendimi i shtetit anëtar, por duhet të përcaktohet nga kritere objektive.”

Është e qartë se neni 27 shfaq një dispozitë relativisht modeste në

---

<sup>10</sup> I. Jeliq, *Të drejtat e pakicave* CID, Podgoricë, 2004, faqja nr.45

kuptimin që kryesisht merret me detyrimet negative të shtetit, në mënyrë që anëtarëve të pakicave nuk u mohohet e drejta për kulturën e tyre, shfaqjen e besimit fetar të tyre dhe të kryejnë detyra fetare ose të përdorin gjuhën e tyre. Sidoqoftë, detyrimet pozitive janë nxjerrë nga kjo dispozitë në literaturën ligjore dhe punën e Komitetit të të Drejtave të Njeriut. Komiteti për të Drejtat e Njeriut e ka adresuar në mënyrë të qartë këtë çështje në paragrafin 6.1 të Komentit të Përgjithshëm nr. 23 (50).<sup>11</sup>

Megjithëse neni 27 nënkuptohet si një detyrim negativ, ai përshkruan ekzistencën e një të drejte dhe dikton që ajo të mos mohohet. Për këtë arsye, një Shtet Kontraktues ka për detyrë të mbrojë ekzistencën dhe ushtrimin e kësaj të drejte nga çdo kufizim apo shkelje.

Masat mbrojtëse pozitive janë të domosdoshme jo vetëm në rastin e shkeljes së të drejtave nga ana e shtetit, qoftë edhe nga autoritetet legjislative, gjyqësore ose administrative por edhe kundër veprimeve të personave të tjerë brenda juridiksionit të një Shteti Kontraktues.

Vetë formulimi i neni 27 nënkupton që përveç mbrojtjes individuale të anëtarëve të pakicave, thelbi i të drejtave të pakicave përfshin edhe dimensionin kolektiv: ata gëzohen “së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tyre.”

Komiteti e përdor këtë dimension kolektiv si pikënisje për të argumentuar në favor të masave pozitive të mbrojtjes: “për sa kohë që masa të tilla futen për të korrigjuar kushtet që parandalojnë ose pengojnë gëzimin e të drejtave të garantuara nga neni 27, ato pasqyrojnë dallim legjitim sipas Paktit bazuar në kritere të arsyeshme dhe objektive “(paragrafi 6.2).

Interpretimi sistematik dhe i qëllimshëm i këtyre dispozitave, përceptimi i saj në kontekst të plotë sëbashku me të drejtat e tjera të njeriut të përmbajtura në PGP dhe kontratave të tjera ndërkombëtare, tregon në mënyrë të nënkuptuar dy të drejta themelore, të drejtat kolektive të njeriut, të cilat duhet të gëzohen nga çdo grup pakicash në çdo pjesë të botës: të drejtat e grupit për mbijetesë dhe mosshqetësimi i ekzistencës fizike dhe e drejta për të siguruar dhe ruajtur identitetin e veçantë të grupit.

---

<sup>11</sup> Vuçiniq, Bjekoviq, Bozhoviq, *ibid*, faqja nr.9



Për të arritur barazinë e tyre, përkatësisht eliminimin e diskriminimit, anëtarëve të pakicave mund t'u garantohet e ashtuquajtura të drejta speciale, domethënë, me qëllim arritjen e barazisë de facto dhe eliminimin e diskriminimit brenda shtetit. Këto masa shpesh referohen në teori dhe praktikë si trajtim preferencial dhe përmbahen në një numër dokumentash për të drejtat e njeriut.

Kur bëhet fjalë për të drejtat e pakicave, momenti kthesë në nivelin global duket se ka qenë miratimi i Deklaratës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1992 mbi të drejtat e personave që i përkasin minoriteteve kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore, e cila ka ardhur në formë rezolute nga Asambleja Kombëtare të Kombeve të Bashkuara, që do të thotë se nuk është e një natyre kontraktuale, e thënë ndryshe nuk ka pasur efekt ligjor të detyrueshëm.

Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e anëtarëve që i përkasin minoriteteve kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore (1992), si dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në këtë fushë, përcakton detyrimin e shteteve për të mbrojtur ekzistencën dhe nacionalitetin ose etnicitetin, kulturën, besimin dhe identitetin gjuhësor të pakicave në territoret e tyre, për të arritur kushtet për përmirsimin e këtij identiteti dhe të miratojë masa të përshtatshme legjislative dhe masa të tjera për të arritur atë objektiv (neni 1). Neni 2 për anëtarët përkatës njeht të drejtat si me poshtë:


- e drejta për të shijuar kulturën e tyre të lirë dhe pa ndërhyrje të shtetit,
- e drejta për të shprehur besimin e tyre,
- e drejta për ritet e tyre dhe për përdorimin privat dhe publik të gjuhës së tyre,
- e drejta për pjesëmarrje efektive në jetën kulturore, fetare, sociale, ekonomike dhe atë publike,
- e drejta për të marrë pjesë në mënyrë efektive në vendimmarrjen në nivel kombëtar, dhe kur është e nevojshme, në nivel rajonal në lidhje me pakicën të cilës i përkasin ose në zonat në të cilat ata jetojnë,
- e drejta për krijimin dhe mirëmbajtjen e shoqatave të tyre,
- e drejta për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe

paqësore me qytetarë të vendeve të tjera me të cilët ata janë në kontakt mbi bazën e lidhjeve kombëtare ose etnike, fetare ose gjuhësore.

Të drejtat e përcaktuara formojnë thelbin e korpusit të të drejtave të pakicave. Gjithashtu, Deklarata përshkruan sjellje të caktuara të shteteve, siç janë detyrimi për të siguruar ekzistencën dhe ruajtjen e identitetit të pakicave dhe për të inkurajuar kushtet për përmirësimin e saj, për të miratuar rregullat ligjore dhe për të vendosur masa të veçanta për ta impletuar atë. Deklarata përcakton se shteti është i detyruar të sigurojë “kudo që është e mundur” marrjen e masave për t’ju mundësuar pakicave të mësojnë gjuhën e tyre amëtare ose të kenë mësim në gjuhën e tyre amëtare.

Anëtarët e pakicave kanë mundësinë që “individualisht, por edhe në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre” të ushtrojnë të drejtat e tyre.

Përveç dispozitave të këtyre dy dokumenteve, Kombet e Bashkuara ka adresuar çështjen e mbrojtjes së të drejtave të pakicave përmes edhe traktateve të tjera, siç është Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (Nenet 2 dhe 4); Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në arsim (neni 5); Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit (neni 11); Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (neni 30).



SISTEMI  
EVROPIAN PËR  
MBROJTJEN E  
TË DREJTAVE TË  
NJERIUT

Mbrojtja e pakicave brenda Këshillit të Evropës (KE) tashmë pasqyrohet në dispozitat e Statutit të kësaj organizate, ku theksohet dëshira për të mbrojtur dhe promovuar lirinë dhe të gjitha vlerat demokratike. Respektimi i të drejtave të njeriut brenda Këshillit të Evropës është vendosur si një nga detyrat dhe kushtet themelore për pranimin në anëtarësimin e tij (Nenet 3 dhe 4 të Statutit).

Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, qëllimet kryesore të Këshillit të Evropës janë ruajtja e demokracisë pluraliste dhe sundimi i ligjit; ndërgjegjësimi dhe inkurajimi i zhvillimit të identitetit kulturor dhe diversitetit të Evropës; kërkimi i zgjidhjeve për problemet me të cilat përballet shoqëria evropiane, përfshirë diskriminimin ndaj pakicave, ksenofobinë dhe intolerancën si dhe dhënija e ndihmës për të konsoliduar stabilitetin demokratik në Evropë duke mbështetur reformën politike, legjislativë dhe kushtetuese. Çështjet e pakicave trajtohen, secila në mënyrën e vet, nga organet kryesore dhe të tjera (Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare, samitet, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, etj.). Përveç kësaj, ka posaçërisht një numër organesh dhe trupa të veçanta që japin kontributin e tyre brenda detyrave specifike që u janë besuar atyre, siç janë Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, Komisioni Evropian për Demokratizimin përmes të Drejtave dhe Komisioneri i Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut.

Megjithëse çështja e pakicave ka qënë dhe është ende shumë e rëndësishme në nivelin rajonal etj, në tokën evropiane, dokumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nuk përmban dispozita të veçanta për mbrojtjen e pakicave. E vërtetë, nën14 i konventës thotë:

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim për asnjë arsye ,siç janë gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, statusi i pronës, lindja o po staturë të tjera.

Sidoqoftë, i referohet vetëm parimit të mosdiskriminimit. Sidoqoftë, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka

treguar se disa shkelje të dispozitave të art.14 lidhen kryesisht me përkatësinë e veçantë kombëtare dhe etnike, pavarësisht nga fakti se nuk ka ndonjë dispozitë specifike që mbron të drejtat e pakicave në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky fakt nuk u korigjua as nga Protokollin nr. 12 i Konventës Evropiane që plotëson dispozitat e Nenit 14 mbi ndalimin e diskriminimit. Risi kryesore e këtij dokumenti është se ai përshkruan ndalimin e diskriminimit në lidhje me çdo të drejtë të parashikuar nga ligji pra, jo vetëm Konventa Evropiane, siç thuhet në nenin 14 të Konventës Evropiane faqa numër 1, Protokollin nr. 12. Protokollin hyri në fuqi në vitin 2005, pas ratifikimit nga dhjetë shtete. Më parë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës propozoi një *Protokoll për të Drejtat e Pakicave në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1993*, por kjo përpjekje mbeti vetëm në nivelin e propozimeve.

*Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Gjuhët e Pakicave (1992)*, si ide themelore për përgatitjen e këtij dokumenti, ka patur aspiratë Këshillin e Evropës që të miratojë një marrëveshje ndërkombëtare brenda kornizës së saj me qëllimin kryesor të mbrojtjes së gjuhës rajonale dhe gjuhët e pakicave. Gjërësisht, për shkak të veprimit të faktorëve të shumtë, kryesisht historike, shumë vende evropiane kanë në territorin e tyre grupe të caktuara, të banuara në rajon, popullsi autoktone ku flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha e shumicës së popullsisë. Karta bazohet në tetë parime themelore, me kushtin që, kur të ratifikohet, shteti merr përsipër detyrime të shumta në fushën e arsimit gjyqësorit, administratës publike, medias, etj. Karta inkurajon një qasje multikulturore dhe në këtë kuptim shmang rregullimin e marrëdhënieve midis gjuhëve zyrtare të aplikuara në të gjithë vendin dhe gjuhëve rajonale dhe të pakicave për sa i përket konkurrencës ose kundërshtimit të tyre.

Karta është specifike sepse nuk pret që shtetet të pranojnë tekstin e tyre ku në tërësi, vetëm një përqindje minimale e dispozitave e cila është e sigurt që jep ruajtjen e shumëllojshmërisë gjuhësore.

Perfundimisht, duhet përmendur se Karta nuk verifikoi listën gjuhësore rajonale apo pakicore, me të cilën ata mbrohen, sapo është

mbajtur qëndrim fleksibel i cili mundëson shteteve vendimarrje për gjuhët ku përcakton mënyrën dhe masta mbrojtëse.<sup>12</sup>

Me ratifikimin e Kartes Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave, Mali i Zi ka pranuar gjuhën Shqipe dhe Rome si gjuhën e pakicave.

Deri më tani katalogu më i madh i të drejtave të pakicave, sot përbahet në dokumentin më të rëndësishëm ligjor rajonal - *Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (1995)*.

Ajo paraqet marëveshjen e parë ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore, e cila i referohet ekzkluzivisht mbrojtjes të së drejtave të anëtarëve të pakicave. Kjo marëveshje nuk meret me të drejtat e përbashkëta të pakicave, vetëm të drejtave të personave të cilët i përkasin këtyre grupimeve. Meqenëse, këto të drejta individuale arrihen përmes zbatimit të parimeve dhe objektivave të vendosura nga Konventa në nivelin kombëtar, nëpërmjet legjislacionit përkatës si dhe masave të duhura dhe politikave të qeverive - shtetet janë të afta deri në një farë mase sipas përceptimit të tyre të hartojnë legjislacionin dhe masat politike të cilat korrespondojnë me rrethanat specifike të tyre. Ja arsyeja se pse ky dokument emërohet "Konventa Kuadër". Prandaj, qasja e zgjedhur u lë shteteve një masë të caktuar lirie në zbatimin e qëllimeve për të cilat ata janë zotuar dhe kështu mundësinë që, në arritjen e këtyre qëllimeve, duke ju përmbytur parimeve të vendosura nga Konventa, të marrin parasysh specifikat, rendit të tyre juridik dhe politik.

Dispozita e Nenit 1 të Konventës Kuadër përcakton që mbrojtja e pakicave kombëtare si dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të atyre pakicave është pjesë integrale e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe si e tillë mer formën e fushëveprimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjithashtu duhet nxjerr në pah se Konventa Kuadër nuk përmban përkufizimin e idesë "pakicat ndërkombëtare", dhe në lidhje me këtë u vendos që të miratohet një qasje pragmatike, mbi bazën e njohurive ku në këtë kohë nuk mund të arrihej asnjë përkufizim që mund të mernte mbështetjen e përgjithshme të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Evropës.

<sup>12</sup> D. Kovaçević, Sistemi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave, Qendra për Studime Etnike, Beograd, f.9 - shkarkuar nga faqja e internetit: [www.kas.de/c/document\\_library/get\\_file?uuid=fd7b812f-ele2-57be-72a8-34483f3080d3&groupId=252038](http://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=fd7b812f-ele2-57be-72a8-34483f3080d3&groupId=252038)

Përveç Preambulës, Konventa Kuadër përmbla strukturë vepruese e cila është e ndarë në pesë pjesë.

Pjesa e parë përmban dispozita që, në përgjithësi, përcaktojnë disa parime themelore që mund të hedhin dritë mbi dispozitat e tjera të rëndësishme të Konventës Kuadër. Pjesa e dytë përmban një listë të parimeve individuale, ndërsa Pjesa e tretë përmban një numër dispozitash të ndryshme në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës Kuadër. Pjesa e katërt përmban dispozita për monitorimin e zbatimit të Konventës Kuadër, ndërsa pjesa e pestë merret me dispozitat përfundimtare, të cilat bazohen në modelin i cili vlen edhe për konventat dhe marëveshjet e arritur brenda Bashkimit Europian.

Prebula vërteton arsyet e miratimit të kësaj konvente dhe shpjegon disa pyetje themelore të cilat krijuesit e saj kishin në mendje. Tashmë fjalët primare theksojnë se këtë instrument mund ta nënshkruajnë dhe ta ratifikojnë edhe ato shtete të cilat nuk janë pjesë e Bashkimit Europian. (neni 2 dhe i 29 i Konventës). Përveç kësaj, Prebula orientohet në qëllimin bazë të Bashkimit Europian dhe në një metodë ku ajo krijohet, dhe ajo është krijimi dhe ruajtja e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.

Paragrafi i parafundit i preambulës përcakton objektivin kryesor të Konventës Kuadër: të sigurojë mbrojtjen efektive të pakicave kombëtare dhe të drejtat e personave që u përkasin atyre pakicave.

Gjithashtu theksohet se kjo mbrojtje duhet të sigurohet brenda shtetit ligjor, duke respektuar integritetin territorial dhe sovranitetin kombëtar të shteteve. Qëllimi i kësaj deklarate është që të paralajmërojë, se si dispozitat e Konventës Kuadër nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt.

Ai nuk merret me ligjet dhe praktikat e Shteteve Palë të Konventës në lidhje me përfshirjen e traktateve ndërkombëtare në rendin e brendshëm ligjor.

Neni 3, i garanton çdo individ i cili i përket një pakice kombëtare, lirinë për të zgjedhur nëse do të konsiderohet apo jo si i tillë. Kjo dispozitë i lejon secilit person të vendosë nëse ai apo ajo dëshiron të jetë nën mbrojtjen që rrjedh nga parimet e Konventës Kuadër, e cila nuk implikon të drejtën e një individ që në mënyrë të detyruar të zgjedhë t'i përkasë ndonjë pakice kombëtare.

Zgjedhja subjektive e një individi është e lidhur në mënyrë të pandashme me kriteret objektive shumë të rëndësishme për identitetin e një personi. Për më tepër, kjo normë siguron parandalimin e pasojave negative të zgjedhjes së lirë të përkatësisë ose ushtrimit të të drejtave që lidhen me atë zgjedhje për secilin person.

Përfundimisht, kjo dispozitë siguron që të drejtat dhe liritë të cilat krijohen nga parimet e Konventës Kuadër mund të ushtrohen individualisht ose në bashkësi me të tjerët. Në këtë mënyrë, njihet mundësia e ushtrimit të përbashkët të këtyre të drejtave dhe lirive, e cila është e ndryshme nga nocioni i të drejtave kolektive. Termi “tjetër” kuptohet në kuptimin më të gjerë të mundshëm dhe përfshin persona që i përkasin të njëjtës nënshtetësi.

Konventa Kuadër garanton qëndrueshmërinë e masave të marra brenda politikës së saj të përgjithshme të integritimit, ndërsa përmbahet nga politikat ose praktikrat e asimilimit të personave që u përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre, përfshirë masat për të mbrojtur personat e tillë nga çdo veprim që synon një asimilim të tillë.

Gjithashtu, pjestarët kanë për detyrë të arrijnë frymën e tolerancës dhe dialogut ndërkulturorë dhe të ndërmarrin masa efektive për përparimin e respektit reciprok, mirekuptimit dhe bashkëpunimit midis individëve të cilët jetojnë në territorin e tyre, pa marrë parasysh etnicitetin, kulturën, gjuhën apo përkatësinë fetare të këtyre individëve, veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe medias.

Konventa, gjithashtu përcakton detyrimin për të marrë masat e duhura për të mbrojtur personat e ekspozuar ndaj kërcënimeve ose diskriminimit, armiqësisë ose dhunës për shkak të identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Përveç realizimit të katalogut, tashmë të njohur të të drejtave dhe lirive të përgjithshme civile dhe politike, Konventa garanton të drejtën për të krijuar institucione, organizata dhe shoqata përmes të cilave këto të drejta realizohen, duke përfshirë ketu rolin e mediave pa diskriminim.

Kjo nënkupton edhe të drejtën e secilit anëtar të një pakice kombëtare për të përdorur lirshëm dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij ose të saj, privatësisht dhe publikisht, duke folur dhe me shkrim.



Kur është e përshtatshme, anëtarët ndërmarrin masa në fushën e arsimit dhe kërkimit më qëllim për të mësuar në lidhje me kulturën, historinë, gjuhën dhe fenë e pakicave dhe shumicave të tyre kombëtare. Në këtë kontekst, ndër të tjera, anëtarët sigurojnë mundësi të përshtatshme për trajnimin e mësuesve dhe qasjen në librat shkollorë, si dhe kontaktet midis studentëve dhe mësuesve nga komunitete të ndryshme, duke promovuar qasje të barabartë në arsim në të gjitha nivelet për personat që i përkasin pakicave kombëtare.

Konventa kërkon krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht në lidhje me çka ju përket vet atyre. Duke vepruar kështu, është e nevojshme ti përmbahen masave që ndryshojnë marëdhënien e popullsisë në zonat e banuara nga persona që u përkasin pakicave kombëtare dhe synojnë kufizimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga parimet e përfshira në këtë Konventë Kuadër.

Garancitë shtesë kanë të bëjnë me vendosjen dhe mirëmbajtjen e kontakteve të lira dhe paqësore përtej kufijve me persona që banojnë ligjërisht në shtete të tjera, veçanërisht ata me të cilët ata kanë një identitet etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar ose një trashëgimi të përbashkët kulturore.

Një pjesë veçanërisht e rëndësishme ka të bëjë me detyrimin për të zbatuar parimet e përfshira në këtë Konventë, me vetëm ato kufizime, restruksione ose shfuqizime - kur është e nevojshme - të përcaktuara nga instrumentet ligjore ndërkombëtare, veçanërisht Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për shtrirja është e rëndësishme për të drejtat dhe liritë që lindin nga parimet e sipërpërmendura.

Të drejtat dhe liritë që rrjedhin nga parimet e përfshira në këtë Konventë, për aq kohë sa ato i nënshtrohen dispozitave përkatëse të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Këshillit të Evropës ose protokolleve të saj, do të konsiderohet të përputhura me dispozitat e tyre.

Më në fund, për të siguruar monitorimin e zbatimit të Konventës Kuadër, Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës i është besuar

detyra e monitorimit të zbatimit të saj nga Shtetet Kontraktuese. Komiteti i Ministrave do të përcaktojë modalitetet për pjesëmarrje në zbatimin e mekanizmave për Palët Kontraktuese jo-CoE.

Për më tepër, për të siguruar një efikasitet më të madh në monitorimin e zbatimit të Konventës, është krijuar një Komitet Këshilldhënës. Detyra e këtij Komiteti Këshillimor është të ndihmojë Komitetin e Ministrave në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të marra nga palët për të zbatuar parimet e përcaktuara në Konventën Kuadër.

Megjithëse çështja e pakicave ka qënë dhe është akoma shumë e rëndësishme në nivelin rajonal, dmth në terrenin evropian, dokumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nuk përmban dispozita të veçanta për mbrojtjen e pakicave. Është e vërtetë që Art. Neni 14 i Konventës thotë: "Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim me cfaredolloj kushti, siç janë gjinia, raca, ngjyra e lekurës, besimi fetar, opinioni politik si dhe opinonet e tjera me origjinë politike apo sociale e cila lidhet me pakicat kombëtare, gjendjen e strehimit, lindjen dhe statuset e tjera por se ai lidhet vetem me principin e diskriminimit.

Nga ana tjetër, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka treguar se shkeljet e caktuara të dispozitave të Artikullit 14 lidhen kryesisht me një përkatësi të veçantë kombëtare dhe etnike. Sidoqoftë, një dispozitë e veçantë që mbron të drejtat e pakicave në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ende nuk ekziston. Ky fakt nuk u korrigjua nga Protokolli nr. 12 të Konventës Evropiane, që plotëson dispozitat e Nenit 14 mbi ndalimin e diskriminimit. Risi themelore e këtij dokumenti është se ai përshtet ndalimin e diskriminimit në lidhje me çdo të drejtë të parashikuar nga ligji i brendshëm dhe jo vetëm nga Konventa Evropiane siç parashikohet nga neni 14 i Konventës Evropiane.

Si pasojë, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në çështjen e Gorzelikut dhe të tjerëve kundër Polonisë (17 Shkurt, viti 2004), shprehimisht refuzoi të vendosë nëse një grup i veçantë mund të kualifikohet si "pakicë kombëtare" por megjithatë njohu të drejtën e një individi të zgjedhë lirisht dhe të deklarojë veten si anëtar i një grupi të caktuar etnik ose kulturor, një vendim i

respektuar nga institucionet shtetërore por me kusht që vendimi të ketë një bazë objektive (Ciubotaru v. Moldova, 27.02.2010). Ky vendim gjyqësor është në përputhje me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, sepse sipas nenit 3 të saj, çdo anëtar i një pakice kombëtare ka të drejtë të zgjedhë nëse do të trajtohet apo jo si i tillë, dhe nga një zgjedhje e tillë ose nga ushtrimi i të drejtave të zgjedhjes individuale, nuk duhet të rezultojë asnje lloj dëmi.

Në çështjen e Sidiropulosit dhe të çështjeve të tjera kundër Greqisë (1998), gjykatësit e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosën mbi korrektësinë e vendimit për të refuzuar regjistrimin e një organizate pakicë maqedonase në bazë të qëllimeve separatiste. Duke cituar standardet ligjërisht jo-detyruese të OSBE-së dhe parimit të interpretimit të Konventës si një instrument të gjallë, u vendos njëzëri se autoritetet greke kishin shkelur të drejtën për lirinë e mbledhjes dhe shoqërimit (neni 11) dhe duhet të njohin regjistrimin e një organizate që synon në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, maqedonasit nga Greqia veriore. Rregulli për tu pranuar regjistrimi në organizat pranohet vetëm atherë nëse nuk ka indikacione të qarta se mund të rrezikojë integritetin territorial dhe sigurinë kombëtare të shtetit i cili u konfirmua në çështjen e Stankov dhe Organizata e Bashkuar Maqedonase linden kundër Bullgarisë (2001), në lidhje me lirinë e shoqatës së anëtarëve të pakicës maqedonase në Bullgari.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut zbatoi për herë të parë nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës në çështjen Sejdiq dhe Finci kundër Bosnje dhe Herzegovinës, viti(2009), duke gjetur diskriminim për shkak të kombësisë së tyre gjatë ushtrimit të së drejtës për të dalë në postin publik sepse ata ishin hebrej, romë dhe pakica të tjera të parandaluara për të kandiduar për zgjedhje në Presidencë dhe Shtëpinë e Popujve të Bosnje dhe Herzegovinës. Gjykata e shikoi këtë situatë në kontekstin e kushteve të ndryshuara, pasi Bosnja dhe Hercegovina është stabilizuar që nga fundi i luftës dhe është zotuar që të ndryshojë dispozitat e diskutueshme kushtetuese duke aderuar në marrëveshje dhe organizata ndërkombëtare.

Si rezultat, autoritetet shtetërore u urdhëruan të ndryshojnë strukturat trepalëshe të qeverisë, të cilat janë në dispozicion vetëm për popujt përbërës, për të mirën e anëtarëve të “të tjerëve”.

Sidoqoftë, në kontekstin e kushteve të dhëna në këtë shtet dhe mungesës së vullnetit politik, ky vendim nuk është ekzekutuar ende.

Praktika e deri tanishme tregon se gjykata ka pranuar të vendosë për problemet specifike me të cilat përballen pjesëtarët e pakicave etnike gjatë ushtrimit dhe përmirësimit të të drejtave të tyre përmes mbrojtjes së identitetit kulturor dhe pjesëmarrjes në jetën politike të një shteti. Duke pasur parasysh që kultura është “një përbërës i qenësishëm i identitetit kombëtar”, gjykata ka pasur mundësinë të vendosë për mbrojtjen e të drejtave kulturore të tilla si përdorimi i gjuhës, arsimit ose mënyrës së jetës, megjithëse Konventa nuk njeh asnjë të drejtë të veçantë për kulturën apo jetën kulturore.

Përveç mbrojtjes së lirisë së themelimit të partive politike, organizatave joqeveritare dhe shoqatave të qytetarëve në favor të ruajtjes së pluralizmit dhe demokracisë, u vlerësua se “bashkëveprimi harmonik i individëve dhe grupeve me identitete të ndryshme është thelbi i ruajtjes së kohezionit shoqëror” (Gorzelik).

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE / OSCE) e bazoi punën e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në dokumenta brenda Konferencës për Sigurinë ( pak më e më pas organizata), e cila filloi me 1 gusht 1975 miratimin e Aktit Përfundimtar të Konferencës së Helsinkit. Megjithëse, ky dokument nuk kishte forcën e një marrëveshje ndërkombëtare, ishte baza për miratimin e një numri dokumentash në fushën e të drejtave të njeriut. Ata kanë fituar një rëndësi të konsiderueshme në Evropë duke pasur parasysh autoritetin që organizata dhe dokumentet e saj kanë brenda vendeve evropiane, megjithëse zyrtarisht nuk kanë qenë të detyruar prej tyre.

Pas këtij dokumenti, pas përfundimit të Konferencës së Vjenës në 1989, hoqën dorë nga doktrina ku të drejtat e njeriut përfshihen rreptësisht brenda kompetencave të brendshme të shtetit. Më pas, u miratua dokumenti përfundimtar, me një seksion të titulluar “Dimensioni Njerëzor i KSBE”. Pas Konferencës së Vjenës, u mbajtën takimet në Paris (1989) dhe në Kopenhagën, viti (1990). Për momentin, për ne seksioni i katërt i këtij dokumenti është veçanërisht i rëndësishëm. Ai i kushtohet çështjeve të pakicave kombëtare, të cilat garantojnë mbrojtje nga asimilimi dhe gëzimi i të gjitha të drejtave të njeriut pa diskriminim dhe rendit një listë të gjatë të të drejtave të veçanta të pakicave kombëtare,

përfshirë të drejtën e përdorimit të gjuhëve, institucioneve fetare dhe arsimore, liria e shoqërimit dhe shprehjes. Për çështjen e pakicave, është e rëndësishme të përmendet dokumenti i ri i Helsinkit, i cili karakterizohet nga forcimi i institucioneve dhe strukturave të KSBE-së.

Puna e OSBE / OSCE-së në këtë fushë u shënuar veçanërisht nga aktiviteti i dy organeve - Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe në veçanti funksionet e pavarura të Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare.

Funksioni i Komisionit të Lartë, me qëllim për të parandaluar konfliktet etnike nëpërmjet veprimeve parandaluese për pakicat kombëtare u miratua në vitin 1992 nga Samiti i Helsinkit.

Prandaj, ai duhet të parandalojë konfliktin duke reaguuar ndaj konflikteve konkrete të pakicave në fazën më të hershme të mundshme sespe sipas konceptit të tij mund të kalojnë në konflikte serioze.

Karakteristikat e tij të rëndësishme të punës janë: pavarësia, paanshmëria, bashkëpunimi dhe besueshmëria ( e ashtëquajtura diploma e fshehtë).

Dokumentet Themelore të OSBE-së janë:

1. Akti Final i Helsinkit (1975)
2. Dokumenti Përfundimtar i Takimit të CSCE në Madrid (1983)
3. Dokumenti Përfundimtar i Takimit të KSBE-së në Vjenë (1989)
4. Dokumenti i Takimit II të Konferencës CSCE mbi Dimensionin Njerëzor (Kopenhagë, 1990)
5. Karta e Parisit për një Evropë të Re (1990)
6. Raporti nga takimi i ekspertëve të KSBE-së për pakicat kombëtare (Gjenevë, 1991)
7. Dokumenti i takimit III të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE (Moskë, 1991)
8. Dokumenti i Helsinkit i CSCE (1992)
9. Dokumenti i Takimit të Tretë të Këshillit të KSBE (Stokholm, 1992)

10. Dokumenti i Takimit të Katërt të Këshillit të KSBE (Romë, 1993)
11. Samiti i II-të i KSBE-së në Budapest (1994)
12. Dokumenti i Lisbonës (1996)
13. Karta për Sigurinë Evropiane (Stamboll, 1999)
14. Deklarata e 14-të e Samitit të Stambollit (1999)

Nga praktika e Komisionit të lartë për pakicat kombëtare ja vlen të përmendet:

- Rekomandimet e Hagës për të Drejtën e pakicave kombëtare për arsim (1996)
- Rekomandimet e Oslos mbi të drejtën e pakicave kombëtare për të përdorur gjuhën e tyre (1998)
- Rekomandimet e Lund mbi pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në jetën publike (1999)
- Raport mbi të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare në zonën e OSBE-së (1999)
- Rekomandime për policimin në shoqëritë multi-etnike (2006)

Rekomandimet e Hagës i vitit 1996 mbi të drejtën e pakicave kombëtare për arsim, përcaktojnë që arsimi i pakicave - veçanërisht në gjuhën e tyre amtare - është bërë një përparësi pasi është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen dhe thellimin e identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare. Gjithashtu, shtetet "atje ku është e nevojshme" rekomandojnë futjen e masave të veçanta për të realizuar të drejtën aktive për arsimim. Sipas rekomandimeve të Hagës, detyrimet përkatëse ndërkombëtare përfaqësojnë një standard minimal ndërkombëtar dhe për këtë arsye nuk duhet të interpretohen në mënyrë kufizuese.

Rekomandimet e Oslos më 1998 mbi të Drejtën Pakicave kombëtare për të Përdorur Gjuhën e Tyre i kushtojnë vëmendje të veçantë përdorimit të gjuhës amtare të pakicave kombëtare në sferën publike dhe private. Në këtë mënyrë, ky dokument rekomandon përdorimin e gjuhës së pakicës në organet administrative dhe në shërbimet publike në rajone dhe vende ku jetojnë një numër i madh i anëtarëve të pakicave kombëtare, në përputhje me dëshirën e demonstruar për

ta bërë këtë. Sipas rekomandimeve të Oslos dhe emrave të personave, institucione private, firmat punëdhënëse, shoqatat kulturore, duhet të shprehen edhe në gjuhën e tyre. Ky detyrim zbatohet në vendet dhe rruget lokale të zonave ku jeton një numër domethënës i anëtarëve përkatëse të pakicave kombëtare.

Organizatat joqeveritare, shoqatat e themeluara dhe të administruara nga anëtarët e pakicave kombëtare, mund të përdorin gjuhën e pakicës.

Rekomandimet e Lund mbi pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në jetën publike u realizuan në vitin 1999. Ata donin të zgjidhnin problemin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në jetën publike. Dokumenti është në formën e rekomandimeve për shtetet. E drejta e pakicave kombëtare për të marrë pjesë në jetën publike lind përmes dy aspekteve të rëndësishme: pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe vetëqeverisjes.

Shteteve në lidhje me pjesëmarrjen në vendimmarrje u rekomandohet të sigurojnë përfaqësim të veçantë të pakicave në legjislaturën, shërbimin civil, ministritë, qeverinë dhe organet e tjera shtetërore. Rekomandimet e Lund parashikojnë gjithashtu krijimin e një sistemi zgjedhor në një mënyrë që do të mundësojë krijimin e partive politike, si dhe një model që do ta bëjë më të lehtë përfaqësimin e pakicave në jetën politike.

